


# Bashkia Kolonjë



## Raporti Performancës 2020



### Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2020 të Bashkisë Kolonjë.

[https://public.tableau.com/views/Kolonje-RaportiInteraktiv2020/Tedhenatadministrative?:language=en&:display\\_count=y&:origin=viz\\_share\\_link](https://public.tableau.com/views/Kolonje-RaportiInteraktiv2020/Tedhenatadministrative?:language=en&:display_count=y&:origin=viz_share_link)

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Kolonjë me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

## **Përmbajtja**

<b>Fjalor shpjegues.....</b>	<b>3</b>
<b>Të dhëna të përgjithshme .....</b>	<b>5</b>
<b>Burimet e Financimit.....</b>	<b>6</b>
<b>Shpenzimet buxhetore.....</b>	<b>7</b>
<b>Investimet.....</b>	<b>8</b>
<b>Treguesit Financiar .....</b>	<b>9</b>
<b>Administrimi i bashkisë.....</b>	<b>10</b>
<b>Arsimi i mesëm i përgjithshëm .....</b>	<b>12</b>
<b>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor .....</b>	<b>14</b>
<b>Shërbime publike vendore.....</b>	<b>16</b>
<b>Menaxhimi i mbetjeve .....</b>	<b>18</b>
<b>Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.....</b>	<b>20</b>

## Fjalor shpjegues

### **Taksat e ndara**

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

### **Tasat vendore**

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

### **Tarifat vendore**

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

### **Transfertat e kushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

### **Transfertat e pakushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

### **Transfertat specifike**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

### **Trashëgimi nga viti kaluar**

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

## **Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport**

**Tregues të performancës së programeve buxhetore.** Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshebull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

**Treguesit kyç financiarë** – llogaritja dhe domethënia e tyre:

- **Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave.** Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave. Me pak ndryshime raporti tregon sesa shpenzon bashkia për të ofruar një Lek shërbime publike.
- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara

nga viti i kaluar. Një raport i lartë është pozitiv për bashkinë pasi tregon se ajo nuk mbështetet në burime të jashtëme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.).

- **Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ndaj totalit të të ardhurave.** Tregon kapacitetin fiskal të bashkisë. Një normë e lartë mund të sygjerojë jo vetëm mbledhjen e mirë të detyrimeve fiskale por edhe taksa apo tarifa të larta.
- **Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifave vendore ndaj planit të tyre.** Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë bëhet e përhershme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.
- **Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore.
- **Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve.** Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- **Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave.** Huaja afatgjatë i referohet një periudhe më të madhe sesa një vit. Një normë e ulët tregon se bashkia është e aftë t'a paguajë borxhin sipas afatit të caktuar. Një normë e lartë mund të sygjerojë se bashkisë do t'i duhet të ulë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë që të shlyejë borxhin.
- **Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave.** Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj.). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.
- **Norma e shpenzimeve për politikën sociale ndaj totalit të shpenzimeve.** Një normë e lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.

#### Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

**Përmirësim**



**Përkeqësim**




**E njëjta situatë**



**Nuk ka informacion**



## Bashkia Kolonjë



Bashkia Kolonjë e pozicionuar në juglindje të vendit përbëhet nga 10 Njësi Administrative: Ersekë, Qendër Ersekë, Leskovik, Qendër Leskovik, Novoselë, Barmash, Mollas, Çlirim me sipërfaqe prej 864.06 km<sup>2</sup>. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ersekës. Popullsia e bashkisë numëron 11,070 banorë (sipas të dhënave të Censurit) me një përfaqësim gjinor 50.2% femra dhe 49.8% meshkuj. Bashkia ka një numër total familjesh prej 2,000 nga të cilat 20% në pjesën urbane dhe 80% në pjesën rurale të bashkisë. Rrjeti rrugor prej 300 km linear shtrihet në rreth 100 km në pjesën urbane të saj.

Bashkia drejtohet në mandatin e parë të tij nga Kryetari **Erion Isaj**, gjatë zgjedhjeve të fundit vendore morën pjesë rreth 32.12% e zgjedhësve.

Viti 2020 shënoi një vit të vështirë për ekonominë e bashkisë dhe shëndetin e popullatës për shkak të situatës Pandemike që është prezente tashmë në mbarë botën. Bashkia u mundua t'i qëndrojë pranë komunitetit sidomos shtresave në nevojë si edhe duke lehtësuar barrën fiskale të biznesit të vogël.

## Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (000 Lekë)		FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
		411,896	324,175	753,594	778,017	97%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Fakt Vs Plan 2020 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga tarifa vendore	26,562	22,384	18,779	56,305	33.35%
	Të ardhura nga taksat lokale	11,177	11,411	15,041	12,933	116.30%
	Të ardhurat e tjera	11,286	7,222	2,742	7,072	38.77%
	Të ardhura nga taksat e ndara	2,583	3,113	19,065	3,740	509.76%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Trasferta specifike	77,437	77,437	401,109	401,109	100.00%
	Trasferta e kushtëzuar	136,386	80,895	131,409	131,409	100.00%
	Trasferta e pakushtëzuar	114,153	114,153	121,125	121,125	100.00%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi pa destinacion	15,409	3,503	44,279	44,279	100.00%
	Trashëgimi me destinacion	16,903	4,057	45	45	100.00%





Figura 1. Peshat e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet në rreth 87% nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit luhaten në kufijtë 8-14% të të gjitha të ardhurave të bashkisë. Edhe pse një vit jashtëzakonisht i vështirë 2020 shënoi një rritje të kontributit të burimeve të veta të financimit kundrejt vitit 2019. Edhe pse një vështirë ekonomik prej situatës pandemike të ardhurat e bashkisë njohën rritje, kështu:

- ☀ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë nga të gjitha burimet e financimit janë dyfishuar
- ☀ Të ardhurat nga burimet e veta të bashkisë janë rritur me 26%, rritje që vjen kryesisht nga taksat dhe taksat e ndara.

# Shpenzimet buxhetore




## Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2020 shënuan një rënie të lehtë kundrejt vitit 2019 me rreth 2%, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2020 ishte rreth 90%. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ *Arsimi i mesëm i përgjithshëm*
- ✿ *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin*
- ✿ *Planifikimi, menaxhimi, administrimi*
- ✿ *Shërbime publike vendore*
- ✿ *Menaxhimi i mbetjeve*
- ✿ *Ujitja dhe kullimi*
- ✿ *Çështje financiare dhe fiskale*

## Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (000 Lekë)	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	REALIZIMI 2020 në %
	173,650	88,807	75,354	80,848	93%



### Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 75 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2019 investimet janë ulur me rreth 15% kjo shpjegon uljen e kontributit të tyre në buxhet. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2020 kundrejt planit është në masën 93%.

Investimet e bashkisë gjatë vitit 2020 kanë shënuar një hap cilësor në menaxhimin financiar:

- ✿ Investimet zënë në fund të vitit 2020 rreth 24% të buxhetit të bashkisë nga 27% në vitin 2019
- ✿ Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: infrastrukturës rrugore, rikonstruksione trotuaresh, institucionet arsimore (Shkolla Petro Nini, Jani Vreto në Ersekë Leskovik), rikonstruksion i terreneve sportive në shkolla, furnizimin me ujë të pijshëm, rikonstruksion ndërtesash për përshtatje të tyre në banesa sociale etj.



# Treguesit Financiar

Treguesit Financiarë të shprehur në %	FAKT 2018	FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2020	TRENDI I PERFORMANCËS
Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave				2.9%	↓
Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	→
Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	→
Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve	42.2%	27.4%	23.8%	22.9%	↓
Norma e shpenzimeve korente ndaj totalit të shpenzimeve	57.8%	72.6%	76.2%	77.1%	↓
Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	0.0%	2.0%	2.0%	2.0%	→
Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave	12.5%	13.6%	7.4%	10.3%	↓
Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave	9.2%	11.6%	5.0%	4.9%	↓
Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	→

## Dy fjalë mbi treguesit kyç financiarë

Treguesit kyç financiarë japin një pamje të menaxhimit financiar të fondeve publike të bashkisë. Përtej tendencave vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkisë, këto tregues synojnë të japin informacion mbi qëndrueshmërinë financiare dhe performancën reale të bashkisë.


Përgjatë vitit 2020 financat e bashkisë karakterizuar nga:

- ✿ Ulja e peshës së investimeve dhe rritja e peshës së shpenzimeve korente (për mirëmbajtje, paga; etj) në tërësinë e buxhetit të bashkisë
- ✿ Ruajtja e mbështetjes së shërbimeve sociale në tërësi
- ✿ Ulja e peshës së të ardhurave të veta të bashkisë në tërësinë e burimeve të financimit të buxhetit të saj
- ✿ Ekzekutimi i buxhetit është eficient pasi është arritur përdorimi i fondeve të disponueshme tërësisht plotësisht.

# Administrimi i bashkisë

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	43,629	14%	91%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



## Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin.

Figura 2: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↓	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numer kundrejt vitit të kaluar)			5	5
↓	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	21.8	15.8	81.8	6.6
↑	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)			4.12	1.33

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Numri total i personave të trajnuar			17	30
• Femra			9	
• Meshkuj			8	
Totali i ditëve të trajnimeve			70	40

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë			5.0	5
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	91	99	70	99
Numri total i punonjësve të bashkisë	211	228	77	228
Punonjës që kanë lëvizur brenda vitit në bashki	46	36	63	15

## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 91% të planit 2020. Bashkia shpenzon rreth 14% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2020 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2020 tregon se:

- ✿ Është shtuar monitorimi i punës së stafit të bashkisë për rrjedhojë është shtuar numri i masave administrative të marra përgjatë një vitipërmirësuar respektimit i kuadrit ligjor dhe rregulloret e administratës. Janë marrë më pak masa disiplinore për punonjësit e bashkisë;
- ✿ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratës. Janë ofruar trajnime për stafin, shumica e tyre online për të respektuar masat anticovid;
- ✿ Është rritur numri i personave që kanë levizur nga puna duke zvogëluar qëndrueshmërinë e administratës.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
<b>Administrimi i bashkisë</b>	3,920	1,486	3,825	3,825	<b>100%</b>
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Administrimi financiar dhe menaxherial i Bashkisë Kolonjë dhe njësisë administrative të saj mirëmbajtjen e Sistemit Financiar dhe Menaxherial të Bashkisë Kolonjë	941	941	392	392	<b>100%</b>
Blerje automjete për nevojat e Bashkisë Kolonjë		6,720			
Blerje Ruli			1,140	1,200	<b>95%</b>
Blerje Sistem Fonia Shpenzime paisje audio-vizuale	1,486	0			
Rikonstruksion i Pjeshëm i godinës të Bashkisë Kolonjë,( Çatia dhe kaldaja )			3,325	3,500	<b>95%</b>
Sistem Dicial sistem sigurie dhe sistemurvejimi			936	936	<b>100%</b>
Vegla pune per ofcinen			240	1,000	<b>24%</b>

# Arsimi i mesëm i përgjithshëm

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	55,681	18%	100%



**Qëllimi i programit buxhetor**  
 Rritja e viteve të shkollimit për qytetarët shqiptarë.  
 (Numri mesatar i viteve të shkollimit të popullatës).

Figura 3: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi i mesëm i përgjithshëm: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↑	Numri i nxënësve të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm publik kundrejt numrit total të nxënësve që përfundojnë arsimin bazë (9 vjeçar) në %	34.00	31.00	37.00	33.00
↓	Numri mesatar i nxënësve në klasë (Raporti numri total i nxënësve në arsimin e mesëm kundrejt numrit total të klasave në arsimin e mesëm publik)	19.2	17.9	23.0	18.8
↓	Shpenzime mesatare për një nxënës në shkollën e mesme (total shpenzime) kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin e mesëm publik (Mijë Lekë / Nxënës)	150.3	303.8	215.8	205.7

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Numri klasave funksionale në sistemin e arsimit të mesëm	14	14	11	14

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Nxënës që përfundojnë sistemin bazë (9-vjeçar)	794	794	697	794
Nxënës që të regjistruar në sistemin e mesëm arsimor (viti 10-12) nga të cilët:	269	250	258	263
• Femra			139	
• Meshkuj			103	
Mësues në sistemin e arsimit të mesëm (viti 10-12)			29	
Total shpenzime për institucionin e arsimit të mesëm në mijë lekë	40,434	75,955	55,681	55,681

## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për grumbullimin, transferimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane në qytet dhe njësitë administrative si edhe pastrimin e rrugëve në pjesën urbane të bashkisë. Ky shërbim bëhet me kontratë nënkontraktuese me kompanitë private. Në masën 100% të planit 2020. Bashkia shpenzon rreth 18% të buxhetit për këtë shërbim. Shërbimi përgjatë vitit 2020 ka synuar:

- ✿ Rritjen e numrit të nxënësve që kanë frekuentuar sistemin e arsimit të mesëm të përgjithshëm;
- ✿ Rritjen e numrit mesatar të nxënësve në klasë dhe të numrit mesatar të nxënësve për një mësues;
- ✿ Uljen e fondeve të alokuara për një nxënës që ndjek arsimin e mesëm të përgjithshëm.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	27,957	62,442	45,080	45,080	100%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Mbikqyrje punimesh për objektin: Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "JANI VRETO" , Leskovik Bashkia Kolonjë	859	0			
Përmirësimi i kushteve në ambientet e konviktit Ersekë, Bashkinë Kolonjë	1,590	0			
Rikonstruksion i shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", Ersekë, Bashkia Kolonjë		22,506	45,029	54,696	82%
Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "JANI VRETO" Leskovik, Bashkia Kolonje	26,280	45,921	3,454	3,636	95%
Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikonstruksion i shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", Ersekë				787	0%

# Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
Realizimi faktik 2020	44,299	14%	100%



## Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor: korentë dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
→	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	100.00	100.00	100.00	100.00
↑	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	7	7.3	7	9
↑	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	12	11.8	11.4	14.8
↑	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)	4,242	1,529	1,772	1,772

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	22	22	25	25
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	66	62	61	61
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	26	26	26	26

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	244	236	206	206
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	794	734	697	900
• Femra	387	357	335	450

• Meshkuj	407	377	362	450
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	114	101	101	101
Mësues në sistemin parashkollor	28	29	29	29
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	244	236	206	206
• Femra	115	112	102	102
• Meshkuj	129	113	104	104
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	100	113	90	90
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë në mijë lekë	93,321	33,644	44,299	44,299

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 100% të planit 2020. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020, ndërkohë që investimet e kryera përgjatë viteve të kaluara bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 14% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2020 tregon se:

- ✿ Është ruajtur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Është përmirësuar norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues edhe pse numri i nxënësve që frekuentojnë këtë sistem arsimor është rritur, nëpërmjet rritjes së numrit të mësuesve.
- ✿ Është rritur financimi i një institucioni arsimor duke synuar përmirësimin e shërbimit.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
<b>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</b>	56,210		6,643	6,643	<b>100%</b>
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Rikonstruksioni i çerdhes			3,239	3,410	95%
Rikonstruksioni i shkolles 9-vjeçare "Papa Kristo Negovani", Ersekë (Shtesë punimesh)	10,419				

# Shërbime publike vendore

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	40,880	13%	95%



## Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj qoftë në qytet apo njësitë administrative.

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Shërbime publike vendore: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↑	Sipërfaqe e gjelbëruar e bashkisë (ndryshimi vjetor në metra katror)		0	6,000	6,000
↑	Rrënjë pemë dekorative (fondi i pemëve në hapësirat e gjelbërta (Ndryshimi vjetor në numër)	180	100	150	150
○	Trotuare (Ndryshimi vjetor në km linear)				

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Rrënjë pemë të mbjella në vit	180	100	150	150
Sipërfaqe e gjelbëruar në vit në metra katrorë		0	6,000	6,000

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Fondi total i pemëve dekorative / gjelbëruese të bashkisë	170	350	500	500
Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave publike në mijë lekë			5,000	5,000
Sipërfaqe totale e bashkisë në km katrorë	864	864	864	864
Sipërfaqe totale e gjelbër publike në m2	27,000	27,000	33,000	33,000
Të ardhurat nga tarifat e gjelbërimit në mijë lekë	20,363	14,152		15,761
Të ardhurat nga tarifat vendore në mijë lekë	26,562	22,384	18,779	56,305
Trotuare në km linear			1,300	1,400



## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për gjelbërimin e hapësirave publike, shtimin dhe përmirësimin e trotuareve, mirëmbajtjen e varrezave publike në masën 95% të planit për vitin 2020. Bashkia shpenzon rreth 13% të buxhetit për këtë shërbim. Performanca e shërbimit tregon se:


- ✿ Është shtuar fondi i pemëve dhe bimëve dekoruese të ambjenteve publike të gjelbëruara nga bashkia
- ✿ Janë shtuar sipërfaqet e gjelbërta të bashkisë me rreth 6,000 metra katrorë kundrejt një viti më parë
- ✿ Janë mirëmbajtur trotuaret, gjatësia e të cilave arrin në rreth 1,300 km linear në fund të vitit 2020.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
<b>Shërbime publike vendore</b>	12,054	8,546	16,189	16,189	<b>100%</b>
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Këndi lojrave				1,700	0%
Modelim pika panoramike					
Rikonstruksion trotuare			1,563	1,563	100%
Shtigjet turistike				567	0%
Shtim sipërfaqe e gjelbër				750	0%

# Menaxhimi i mbetjeve

Realizimi faktik 2020	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2020
	20,158	6,4%	100%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



## Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i mjedisit duke mirëmenaxhuar mbetjet urbane për të mbrojtur shëndetin e popullatës dhe krijuar kushte më të mira për zhvillimin e turizmit.

Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i mbetjeve: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↓	Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuar (Mijë Lekë për 1 tonë mbetje (kosto operative dhe mirëmbajtje plus investime)	0.0	208.9	224	224
↓	Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në qytet dhe Nj.Administrative Ndryshimi në herë	0	0	-1	-1
↑	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës (në %)	59.0	59.0	61.6	59.0
→	Raporti i territorit të mbuluar me shërbim kundrejt totalit të territorit (në %)	40.5	40.5	40.5	40.5
○	Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt shpenzimeve totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (në %)		25.0		40.1

## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për grumbullimin, transferimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane në qytet dhe njësitë administrative si edhe pastrimin e rrugëve në pjesën urbane të bashkisë, në masën 100% kundrejt planit 2020. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 6.4% të buxhetit



të saj. Ky shërbim bëhet me kontratë nënkontraktuese me kompanitë private. Bashkia e ka përmirësuar këtë shërbim përgjatë viteve duke dërguar pothuajse gjysmën e mbetjeve në landfillin rajonal të Maliqit. Kjo ka rritur konston e transportit të shërbimit, por ka përmirësuar mjedisin dhe rritur mundësitë për turizëm. Performanca e shërbimit përgjatë vitit 2020 tregonse:

- ✿ Është ulur frekuenca e tërheqjes së mbetjeve me një herë në javë përkatësisht në qytet dhe në njësitë administrative
- ✿ Rritur kosto mesatare e menaxhimit të 1 ton mbetje (grumbulli, transferim)
- ✿ Rritur popullata e mbuluar me shërbim nga 59% në 2019 pothuajse 62% në 2020.
- ✿ Bashkia synon përmirësimin e mbulimit të kostos së shërbimit nga mbledhja e të ardhurave të tarifës së shërbimit. Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë për rrjedhojë nuk kemi rezultate konkrete ende, por ky është fokusi i punës së bashkisë në vitet në vazhdim.

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (mesatare Q+NjA)-në qytet dhe Nj.Administrative	5	5	4	4
• Fekuenca në Qytet	7	7	5	5
• Frekuenca në Njësitë administrative	3	3	2	2
Popullsia e mbuluar me shërbim	11,000	11,100	11,500	11,500
• Popullsia e mbuluar me shërbim në Njësitë Administrative			1,500	1,500
• Popullsia e mbuluar me shërbim në Qytet			10,000	10,000
Sasia totale të mbetjeve të menaxhuara (mbledhur + transferuar + trajtuar) në tonë	1,000	1,000	1100	1100
• Sasia e mbetjeve në Njësitë administrative			300	300
• Sasia e mbetjeve në Qytet			700	700
Sipërfaqe e mbuluar me shërbim në km2			350	350

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Buxheti për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve		20,889	20,158	20,158
Të ardhurat nga tarifat e shërbimit të mbetjeve (në mijë lekë)		5,217		8,000
Popullsia totale nën administrimin e Bashkisë	18,704	18,881	18,683	18,683
• Popullsia në Njësitë administrative			8,683	8,683
• Popullsia në Qytet			10,000	10,000
Sipërfaqe totale e bashkisë në km2	864	864	864	864

# Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit



## Qëllimi i programit buxhetor

Mbështetja e prodhimit bujqësor dhe aktivitetit të fermerëve nëpërmjet menaxhimit të infrastrukturës sekondare dhe terciare të kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakti 2020	Plan 2020
↑	Kilometra linear kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (Raporti në %)			15.3	14.7
↓	Kilometra linear kanal ujitës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (Raporti në %)			63.8	68.8
↑	Kosto mesatare për 1 km linear kanal ujitës dhe kullues të menaxhuar (Buxheti i shpenzuar për ujitje dhe kullim kundrejt kilometrave total te sistemit ujitjes dhe kullues Mijë Lekë/për km)			209.0	323.7
→	Numri i familjeve përfituese të shërbimit të vaditjes dhe kullimit (Ndryshimi vjetor në numër)			950.0	950.0
↑	Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim (Ndryshimi vjetor në ha)		50.0	481.0	481.0
→	Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje (Ndryshimi vjetor në ha)		170.0	0.0	10.0
→	Sipërfaqja e tokës bujqësore e kultivuar kundrejt totalit të tokës bujqësore (Raporti në %)			44.7	44.7

## Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për për ndërtimin dhe organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, nën përgjegjësinë e bashkinë në të gjitha njësitë administrative të saj, në masën 71% kundrejt planit 2020. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 5% të buxhetit të saj. Me investime të rëndësishme të përvitshme nga buxheti i bashkisë performanca e këtij shërbimi tregon se janë të justifikuar pasi:

- ✿ Bërjen funksionale të kanaleve kulluese dhe vaditëse – pastrimin e mëtejshëm të tyre
- ✿ Rritjen e sipërfaqes bujqësore të mbuluar me shërbimin e ujitje dhe ruajtjen e të njëjtit shërbim për to në lidhje me kullimin
- ✿ Uljen e kostos së pastrimit të një kilometri linear kanal kullues dhe vaditës duke rritur eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim të ofruar nga bashkia
- ✿ Bërja funksionale e sistemit vaditës dhe kullues ka mundësuar që sipërfaqja e tokës së kultivuar të rritet në vazhdim.

Produkte	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Familje përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit			950	950
Kanal kullues i pastruar			8	8
Kanal ujitës i pastruar			51	55
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim në ha	200	250	731	731
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje në ha	2,200	2,370	2,370	2,380

Të dhëna	Fakti 2018	Fakti 2019	Fakt 2020	Plani 2020
Buxheti i shpenzuar për ujitje dhe kullim në lekë	27,518	18,858	12,300	20,231
Sipërfaqe e tokës bujqësore (fondi bujqësor sipas inventarit)			11,185	11,185
Sipërfaqe e tokës së kultivuar			5,000	5,000
Sistemi kullues në km linear			51	51
Sistemi ujitës në km linear			80	80

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
<b>Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit</b>	16,911	9,500	1,514	6,942	22%
Në mijë Lekë					

Emërtimi i Projektit	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Realizimi në %
Lera			444	444	100%
Prita			334	334	100%
Rikonstruksion i kanalit ujitës Erseke-Tac Poshte					
Rikonstruksion i kanalit ujitës Leskovik					
Rikonstruksion i Rrjetit ujitës rezervuari Kabash, Njësia Administrative Leskovik		10,000	4,694	4,942	99%
Supervizim +Kolaudim investimet e prishme viti 2020		1,081	871	2,213	40%

